



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.557/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti Kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të mungesës së materialeve për informimin e votuesve të afishuara në Qendrat e Votimit gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa Anr.557/2025, e datës 10.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mungesës së materialeve për informimin e votuesve të afishuara në Qendra të Votimit gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 10.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se me datë 09.02.2025 ditën e mbajtjes së Zgjedhjeve të Përgjithshme Parlamentare në Republikën e Kosovës, në qytetin e Kamenicës në të gjitha Qendrat e Votimit, në materialin për informimin e votuesve të afishuar në hyrje të Qendrës së Votimit, fshatin Topanicë Vendvotimi 3804/03, Vendvotimi në fshatin Pjetershtice, Qendra e Votimit: 2210/01, Qendra e Votimit në shkollën "Haxhi Hoti" Shtime 0216, mungon subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje!. Po ashtu lista me kandidatet për deputet të Lëvizjes Vetëvendosje! mungon në broshurën e kandidateve të subjekteve politike pjesëmarrëse në Zgjedhjet Parlamentare. Po ashtu, e njëjta situatë, është identifikuar në Shkollën "Skender Luarasi" në Suharekë, Qendra e Votimit më numër 2401, në të cilën mungon lista e kandidatëve për deputetë nga radhët e LVV-së. Provë: Foto (Lista e subjekteve politike me kandidatet përkatës e afishuar në Qendrën e Votimit. Me nenin 4 paragrafi 1 të Rregullës Zgjedhore është përcaktuar se: "KQZ sigurohet që të përgatitë materialin për informim të votuesve në VV dhe në QV". Menaxheri i QV dhe KV obligohet që të njëjtat t'i vendosin një ditë para ditës së zgjedhjeve në hapësira të QV dhe në V. Në paragrafin 2 piken 2.1 dhe 2.2 të nenit të sipërpërmendur shprehimisht në kategorinë e materialit për informimin e votuesve përfshihen Lista e subjekteve politike, që janë të paraqitura në fletëvotim dhe lista e kandidatëve të secilit subjekt politik, siç janë të paraqitur në broshurën e kandidatëve për zgjedhjet përkatëse. Në rastin konkret KQZ i ka mohuar të drejtën e informimit të drejtë të saktë dhe në kohë të gjithë votuesve të cilën janë paraqitur për të votuar në këto Qendra Votimi. Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, kërkojmë nga PZAP që të urdhëroj KQZ-në që në të gjitha Qendrat

e Votimit në Republikën e Kosovës të vendos materialin informues për votuesit bazuar në dispozitat e Rregullores Zgjedhore nr. 12/2024 të KQZ.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja lidhur me mungesën e materialeve për informimin e votuesve të afishuara në Qendrën e Votimit në Kamenicë, Suharekë dhe Shtime, KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP-it, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunave të lartcekura, duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim: KKZ, në komunën e Suharekës, ka njoftuar KQZ, lidhur me ankesën e palës ankuese se, në Qendrën e Votimit 2401 "Skender Luarasi" janë shpërndarë këto dy faqe dhe menaxheri duke menduar se janë të njëjta i ka vendosur ndaras, pjesën e parë (1/2) ku kanë qenë lista e kandidatëve të "Lëvizjes Vetëvendosje!" e ka vendosur në korridor të shkollës në një hapësirë lehtë të dukshme për votuesit, ndërsa pjesën e dytë në hyrje të shkollës siç shihet në foto të ankesës.

KKZ, në komunën e Shtimes, ka njoftuar KQZ, lidhur me ankesën e palës ankuese se, në vendvotimin 2210/01, lidhur me pretendimet se ka munguar broshura për kandidatë të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ju njoftoj se gjatë verifikimit të materialit të pranuar në Qendrën Komunale nuk ka pasur asnjë informacion se ka munguar një material i tillë. Verifikimi dhe selektimi i materialit është bërë në prani të gjithë anëtarëve të KKZ-së, pra edhe përfaqësuesi i Lëvizjes Vetëvendosje në KKZ-në Shtime, nuk ka paraqit asnjë vërejtje për ndonjë mungesë të broshurave apo ndonjë material tjetër (Verifikimi i materialit është bërë më 09.02.2025). Edhe gjatë ditës zgjedhjeve 09.02.2025, nuk kemi pasur informacione se ka munguar broshura e kandidatëve në asnjë vendvotim. Në KKZ-në Shtime gjatë ditës të votimit 09.02.2025, askush nuk e ka lajmëruar një mungesë të tillë, dhe nuk kemi asnjë shënim në Librin e Votimit i cili është procesverbal i asaj dite. Prandaj duke u nisur nga fakti që nuk kemi pasur asnjë informacion për një mungesë të tillë nuk kemi mundur as me ndërmarrë ndonjë veprim për këtë.

KKZ, në komunën e Kamenicë, ka njoftuar KQZ, lidhur me ankesën e palës ankuese se, me datë 08.02.2025 ka bërë shpërndarjen e materialit jo sensitiv dhe të gjithë kryesuesit e vendvotimeve e kanë pranuar këtë material, duke përfshirë edhe materialin për informim të votuesve. Gjatë ditës së zgjedhjeve KKZ është informuar se në dy qendrat e votimit në qytetin e Kamenicës me numër 1001 dhe 1002, si dhe qendrën e votimit në Topanicë me numër 1004/1 dhe 1004/2, mungon pjesa e parë e afishit informues të listës me emra të kandidateve të subjekteve politike. Me të kuptuar për këtë, KKZ ka intervenuar përmes menaxhereve dhe është bërë vendosja e pjesës së materialit të munguar (faqja e 1/2). Gjithashtu, KKZ është siguruar që çdo kabinë e votimit në të gjitha vendvotimet të ketë listën me emra të kandidateve të subjekteve politike, në mënyrë që të gjithë votuesit të jenë të informuar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë vëren se ankesa është e pa bazuar.

Pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV me të cilën pretendon se kanë munguar materialet për informimin e votuesve të afishuara në fshatin Topanicë, Komuna e Kamenicës, në fshatin Pjetershtice, Komuna e Shtimes, dhe në Shkollën "Skender Luarasi" në Komunën e Suharekës, paneli vlerësoi se janë të paqëndrueshme sepse nuk ka asnjë provë të bazuar lidhur me këto pretendime. Në fotot e bashkangjitura në ankesë shihen disa fotografi nga e cila vërehet që është shënuar lista e kandidatëve të subjekteve politike, por nga kjo listë nuk mund të shihet dhe nuk mund të vërtetohet se mungon edhe lista me kandidatët e subjektit politik LVV për të cilën pretendon pala në ankesë.

Po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ-së vërehet se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtruara me ankesë se kanë munguar listat e kandidatëve të subjektit politik LVV, ky fakt vërtetohet nga KKZ e komunave, Kamenicë, Shtime dhe Suharekë, si dhe nga personat kompetent të qendrave të votimit të potencuar në ankesë të cilët e mohojnë një gjë të tillë.

Për më tepër parashtruesi i ankesës qendrës së votimit në fshatin Topanice i'u është referuar gabimisht me numrin 3804/03, ndërsa qendra e votimit në këtë fshat ka numër 1004. Ndërsa pretendimet për qendër të votimit në Komunën e Shtimes me numër 0216 dhe me emër të shkollës "Haxhi Hoti", Paneli pas hetimit të bërë, vëren se kjo qendër nuk ekziston me këtë numër dhe me këtë emër të shkollës në Komunën e Shtimes.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e tij.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe hetuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuar në ligj, andaj ankesa u refuzua e pa bazuar në kuptim të nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.557/2025, datë 13.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.